

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7907
E mërkurë, 16 tetor 2024
Çmimi 0.50

Politologu Albinot
Maloku: Qeveria
e shkeli edhe parimin
e reciprocitetit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HAP I RI HISTORIK I SHQIPËRISË | FAQE 4-5

- Shqipëria hap kapitullin e parë për negociatat e anëtarësimit në BE



Shqipëria ka hapur të martën kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën e përbashkët për medie

me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szijjarto, në Luksemburg, e vlerësoi si historik këtë moment. Ai ka theksuar se Shqipëria ka përmbytur në mënyrë absolute të

gjitha parakushtet për të nisur këtë fazë të anëtarësimit dhe mbetet e palëkundur në vendosmërinë e saj për të përmbytur të gjitha detyrimet e ardhshme

OPINION

HESHTJA NDAJ SPECIALES,
REKOMANDIM APO TRADHTI?! | F. 6

Shkruan:
Sali BISLIMI



AKTUALE



UDHËHEQËSIT E BE-SË PËRPËLITEN
PËR MIGRIMIN | F. 2

MALI I ZI ME MË PAK SE 5% TË
BANORËVE SHQIPTARË | F. 5

EKONOMI



MARRËVESHJET E CEFTA-s
DHE PLANI I RI I VEPRIMIT PËR
TREGUN E PËRBASHKËT RAJONAL
NË FOKUS NË SAMITIN E 10
TË PROCESIT TË BERLINIT | F. 8

KMDLNJ: TRAJTIM JONJERËZOR DHE
DEGRADUES I PENSIONISTËVE | F. 8

SPORT



KOSOVA TRIUMFON NDAJ QIPROS
NË 'FADIL VOKRRI' | F. 10

**KURTI PRET
DINAMIKË
TË RE NGA
KOMISIONI
I RI EVROPIAN
RRETH PROCESIT
TË DIALOGUT | F. 3**



**KRYETARI I
SBASHK-ut:
MINISTRI MURATI
KUR FLET PËR
PAGAT NUK KA
PSE KRENOHET,
PO DUHET
TË SKUQET | F. 7**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Udhëheqësit e BE-së përpëliten për migrimin

BRUKSEL, 15 TETOR - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian mbledhen në Bruksel më 17 dhe 18 tetor për samitin e tyre të rregullt të vjeshtës. Takimi është i fundit para zgjedhjeve presidenciale në ShBA, që do të mbahen në nëntor, si dhe zgjedhjeve presidenciale dhe referendumit për anëtarësimin në BE në Moldavi, më 20 tetor, dhe zgjedhjeve parlamentare në Gjeorgji, më 26 tetor.

Në Bruksel bisedimet për Ukrainën do të jenë kryesoret, edhe pse priten pak vendime. Çështje e nxehtë pritet të jetë debati për migracionin, i cili mund të ketë pasoja për disa vende që shpresojnë t'i bashkohen një ditë BE-së.

Draft-konkluzionet e samitit, që i pa Radio Evropa e Lirë, përfshijnë pak të reja për Ukrainën. Përveçse përmendet një lloj "samiti i paqes", që do të mbahej deri në fund të vitit, duke përfshirë potencialisht edhe pjesëmarrjen ruse, në tekstin e konkluzioneve thuhet, thjesht, se "Këshilli Evropian thekson se nuk mund të ndërmerret ndonjë iniciativë për Ukrainën pa Ukrainën".

Draft-dokumenti lë të kuptohet se nuk do të ketë sanksione të reja kundër Rusisë dhe se, në vend të tyre, udhëheqësit, në fund të samitit, do të theksojnë nevojën për "zbatim të plotë dhe efektiv të sanksioneve dhe për masa të mëtejshme për ta luftuar shmangien e tyre, përfshirë edhe përmes vendeve të treta".

Për ndihmën ekonomike, ambasadorët e BE-së ranë dakord, javën e kaluar, për 35 miliardë euro të tjera ndihmë financiare për Kievin për vitin 2025, të cilat i morën nga asetet e ngrira të Bankës Qendrore të Rusisë në BE.

Megjithatë, BE-ja nuk u pajtua për zgjatjen e sanksioneve ndaj

këtyre aseteve - nga gjashtë muaj në 36 muaj.

Kjo zgjatje do t'u lejojte vendeve të tjera të G7-s, apo grupit të vendeve më të industrializuara, të ofronin fonde, gjithashtu.

Hungaria, aktualisht, është duke e bllokuar zgjatjen e sanksioneve dhe një vendim për këtë çështje ka të ngjarë që Brukseli të mos e marrë deri pas zgjedhjeve presidenciale në ShBA.

Në votimet e ardhshme në Moldavi, draft-konkluzionet e samitit nxjerrin në pah përpjekjet e Kremlinit për të ndikuar në proces, përmes manipulimeve dhe ndërhyrjeve në informacione.

Ndonëse nuk mban anë publikisht, është e qartë se Brukseli shpreson që moldavët të votojnë për BE-në si në referendum ashtu edhe në zgjedhjet presidenciale.

Vetëm javën e kaluar BE-ja vendosi për ngrirjen e aseteve dhe ndalimin e vizave për pesë persona, përfshirë Evghenia Gutulin, guvernatore proruse e rajonit autonom moldav të Gagauzisë.

BE-ja sanksionoi edhe Evrazia-n, një OJQ me bazë në Rusi, e themeluar për t'i promovuar interesat ruse në Moldavi.

Për më tepër, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, udhëtoi së voni në kryeqytetin e Moldavisë, Kishinjev, ku prezantoi një paketë financiare për këtë vend, me vlerë prej 1.8 miliard eurosh për tre vjetet e ardhshëm.

Për Gjeorgjinë, disponimi është padyshim më i zymtë.

Draft-konkluzionet nxjerrin në dukje një "shqetësim serioz për kursin e veprimit në Gjeorgji, i cili bie ndesh me vlerat dhe parimet mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian" dhe theksojnë se zhvillimet e fundit në Gjeorgji, rrezikojnë rrugën e vendit drejt BE-së dhe



"de facto ndalojnë procesin e anëtarësimit".

Miratimi i të ashtuquajturit "ligj për agjentët e huaj" dhe "ligji anti-LGBT" në Gjeorgji e ka shtyrë BE-në t'i anulojë vizitat politike të nivelit të lartë në Tbilisi dhe t'i bllokojë disa fonde të dedikuara për vendin e Kaukazit Jugor.

Brukseli nuk e përjashton mundësinë e miratimit të më shumë masave në të ardhmen, nëse Gjeorgjia devijon më tej nga demokracia.

Por, diskutimi më intensiv në samitin dyditor të kësaj jave pritet të përqendrohet rreth migrimit.

Rreshti më i diskutueshëm në draft-konkluzione ka të bëjë me "mënyrat e reja për të parandaluar dhe luftuar migrimin e parregullt... në përputhje me ligjin ndërkombëtar".

Kjo është diçka si vazhdimësi e një letre të shkruar nga 15 shtete anëtare të BE-së - drejtuar

Komisionit Evropian në qershor - në të cilën theksohej nevoja për partneritete të ndryshme me vendet joanëtare të BE-së.

Kjo mund të nënkuptojë pagesën e vendeve si Tunizia dhe Turqia, për t'i parandaluar migrantët që të arrijnë në BE, ose skema të tjera, të tilla si ajo që po zhvillohet midis Italisë dhe Shqipërisë - ku Roma po ndërton kampe për të strehuar deri në 40.000 migrantë në vit, që kapen në det.

Ideja e krijimit të këtyre "pikave të nxehta të jashtme" jashtë BE-së, ku autoritetet do t'i shqyrtojnë kërkesat e azilkerkuesve përpara se të hyjnë në BE, po fiton terren. Qëndrimet më të ashpra ndaj migracionit vijnë disa javë pasi Gjermania vendosi kontrollin në të gjithë kufijtë e saj. Kjo pasoi një sulm në perëndim të Gjermanisë në verë, kur një azilkerkues i dështuar vrau tre persona.

Qëndrimet e tilla vijnë, gjithashtu, pasi partitë kundër imigracionit dolën të parat në zgjedhjet parlamentare në

Austri, më 29 shtator, dhe qëndrojnë mirë në sondazhet e fundit në Republikën Çeke dhe në Gjermani.

Vlen të theksohet se edhe Qeveria franceze, e formuar së voni, është e varur nga Tubimi Kombëtar i partisë së ekstremist të djathtë të Marine Le Penit, dhe se forca të ngjashme politike janë duke drejtuar ose ndikuar qeveritë në shtete të tjera kryesore të BE-së, si Italia, Holanda dhe Suedia.

Është vetëm një numër i vogël i vendeve, veçanërisht Spanja, që ngurrojnë të miratojnë politika më kufizuese të BE-së për migracionin.

Ndërsa samiti i BE-së nuk do të hyjë në detaje në lidhje me vendet e tjera që mund të luajnë një rol të ngjashëm si Shqipëria, sa u përket migrantëve, ka mundësi që vendeve të tjera kandidatë për BE, për shembull atyre në Ballkanin Perëndimor, t'u kërkohej diçka e ngjashme. (REL)

OKB-ja: Më shumë se 400 000 fëmijë janë zhvendosur si pasojë e luftimeve në Liban

NJU-JORK, 15 TETOR - Më shumë se 400 000 fëmijë në Liban janë zhvendosur në tre javët e fundit, tha një zyrtar i agjencisë së Kombeve të Bashkuara për fëmijët. Ai paralajmëroi për "gjeneratë të humbur" në shtetin e përfshirë nga shumë kriza dhe tani po përballet edhe me luftë.

Izraeli ka përshkallëzuar fushatën e tij kundër Hezbollahit - grupit militant dhe partisë politike që kontrollon shumicën e Libanit jugor, përfshirë edhe duke nisur një ofensivë tokësore, pasi për një vit ka këmbyer zjarr në kufi, në kohën kur paralelisht po zhvillon luftë në Gazë kundër Hamasit, grupit palestinez të shpallur



organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Hezbollahu është shpallur

organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, derisa Bashkimi Evropian e ka në listë të zezë vetëm krahun e armatosur, por jo

partinë, e cila ka ulëse në Parlamentin e Libanit.

Luftimet në Liban kanë detyruar 1.2 milion persona të largohen nga shtëpitë e tyre, shumica e tyre kanë ikur në Bejrut dhe në pjesë të tjera në veri të shtetit gjatë tri javëve të fundit, që kur janë përshkallëzuar luftimet.

Ted Chaiban, zëvendëseshfi për veprime humanitare në UNICEF, ka vizituar shkollat që janë shndërruar në strehimore për familjet e zhvendosura. "Këto tri javë të luftës kanë ndikuar shumë fëmijë", tha Chaiban për Associated Press. "Aktualisht, 1.2 milion janë të privuar nga shkollimi. Shkollat e tyre publike

ose janë të paqasshme, ose janë dëmtuar nga lufta, ose po përdoren si strehimore. Gjëja e fundit që i duhet këtij shteti është rreziku i një gjeneratë të humbur", shtoi ai.

Përderisa shkollat private libaneze ende janë duke operuar, sistemi publik i arsimit është goditur rëndë nga lufta.

Më shumë se 2 300 persona në Liban janë vrarë gjatë sulmeve izraelite, pothuajse 75 për qind e viktimave janë regjistruar në muajin e fundit, sipas Ministrisë libaneze të Shëndetësisë. Në tri javët e fundit më shumë se 100 fëmijë janë vrarë dhe më shumë se 800 janë plagosur, tha Chaibani.

Kurti pret dinamikë të re nga Komisioni i ri Evropian rreth procesit të dialogut

PRISHTINË, 15 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Kosova pret që Komisioni i ri Evropian të nisë me një dinamikë të re sa i përket dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Pas samitit të Procesit të Berlinit, Kurti u pyet për kërkesat e tij sa i përket dialogut, pasi kancelari gjerman Olaf Scholz kërkoi dinamikë të re në këtë proces që ndërmjetësohet nga blloku evropian. "Ne po presim Komisionin e ri Evropian që të fillojë me dinamikë të re dhe për këtë arsye jemi optimistë. Edhe më tej insistojmë që të dorëzohet kryekrimineli Millan Radoičiq, që na vrau rreshterin Afrim Bunjaku, por edhe grupi i tij paralimitar i terroristëve që ndodhen në aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës. Kërkojmë që letra e [ish-kryeministres serbe, Ana] Bërnabiqit të tërhiqet, meqë me atë letër ajo është tërhequr nga Marrëveshja [për rrugën drejt normalizimit të raporteve]. Njëkohësisht ajo që jemi marrëvesh, Marrëveshja Bazë dhe Aneksi për zbatim, të nënshkruhen sepse nënshkrimi është garanci ligjore", tha Kurti për gazetarët.

Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia

arritën Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën dhe për Aneksin e zbatimit të saj, por nëpërmjet një letre dërguar në Bruksel në dhjetorin e vitit 2023 nga kryeministrja e atëhershme serbe, Ana Bërnabiq, Beogradi shprehu rezervën për këtë marrëveshje.

Në letër Bërnabiq ka thënë se Marrëveshja është e pranueshme për Serbinë vetëm në një kontekst që nuk i referohet njohjes de facto dhe de jure të Kosovës. Aty, po ashtu, thuhet se Beogradi nuk pajtohet me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara apo në mekanizma dhe në agjenci që ekzistojnë në kuadër të OKB-së.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Marrëveshja nuk është nënshkruar, por BE-ja ka thënë se ajo është ligjërish e



obligueshme për palët, teksa blloku evropian vazhdimisht u kërkon palëve ta nisin zbatimin e saj.

Gjatë deklaratimit për gazetarët, Kurti tha se në takimet që ka

zhvilluar në Berlin ka kërkuar që BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës vitin e kaluar për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës, por edhe t'i jepet statusi i vendit kandidat.

Kosova është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk e ka statusin e vendit kandidat, teksa vendi ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022.

PDK-ja thërret seancë të jashtëzakonshme për mesazhet Mihali - Krasniqi dhe falja e ambalazhuesve të ujit



PRISHTINË, 15 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka bërë me dije të martën se kanë kërkuar që të mërkurën të mbahet seancë e jashtëzakonshme.

Arsyeja e thirrjes së seancës, tha ai, është falja e borxheve të ambalazhuesve të ujit dhe mesazhet ndërmjet Dejona Mihalit dhe ish-kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi. "Nesër nga ora 12:00/h në emër të 41 deputetëve të opozitës kemi ftuar

seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës për t'i trajtuar keqpërdorimet e rreth 11 milionë eurove të faljes së kundërligjshme të borxheve të kompanive ambalazhuesve të ujit nga qeveria e kryeministrit Albin Kurti, për të cilin rast tashmë ka edhe të arrestuar, e procesi është nën hetime penale. Në këtë seancë domosdoshmërisht do të trajtohet edhe udhëheqja e kundërligjshme e sistemit tonë energjetik nga Dejona Mihali", ka theksuar Tahiri.

Hovenieri: Amerika e palëkundur për mbështetjen e misionit të NATO-s në Kosovë

PRISHTINË, 15 TETOR - Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se ishte privilegj pjesëmarrja në ceremoninë e ndërrimit të komandës së KFOR-it në Kosovë, ceremoni kjo e cila u mbajt të premtën që shkoi. Në një postim në "X", Hovenieri shprehu vlerësim të thellë për

udhëheqjen dhe shërbimin e Ozkan Ulutashit, ndërkaq i uroi mirëseardhje të ngrohtë gjeneralmajorit italian Enrico Barduanit. "Ishte privilegj të merrja pjesën në ceremoninë e ndërrimit të komandës së KFOR-it. Vlerësim të thellë për udhëheqjen dhe shërbimin e Ulutashit, dhe mirëseardhje të

ngrohtë për Barduanin ndërsa merr komandën e këtij misioni kritik. Shtetet e Bashkuara mbeten të palëkundura në mbështetjen e tyre për misionin e NATO-n, në sigurimin e lirisë së lëvizjes dhe mjedisit të sigurt në Kosovë", ka shkruar ambasadori amerikan.





HAP I RI HISTORIK I SHQIPËRISË

- Shqipëria hap kapitullin e parë për negociatat e anëtarësimit në BE

Shqipëria ka hapur të martën kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën e përbashkët për medie me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szijjarto, në Luksemburg, e vlerësoi historik këtë çast. Ai ka theksuar se Shqipëria ka përmbushur në mënyrë absolute të gjitha parakushtet për ta nisur këtë fazë të anëtarësimit dhe mbetet e palëkundur për t'i përmbushur të gjitha detyrimet e ardhshme

Kryediplomati hungarez Szijjarto tha se procesi i zgjerimit të BE-së duhet të përshpejtohet. "Na duhet energjia e re dhe kjo do të vijë nga hapësira e Ballkanit Perëndimor. Është në interes të BE-së që zgjerimi të përshpejtohet. Na duhet të marrim hapa urgjente për ta ruajtur besueshmërinë e politikës së zgjerimit. Duhet ta përshpejtojmë procedurën e zgjerimit tani", ka thënë ai.

Szijjarto ka theksuar se Shqipëria është gati për t'iu bashkuar BE-së, duke shtuar se shpreson që Brukseli t'i bëjë "detyrat burokratike" dhe që një tjetër konferencë të realizohet brenda presidencës hungareze.

Edhe komisionari për zgjerimin e BE-së, Oliver Varhelyi, nënvizoi rëndësinë e zgjerimit të BE-së. "Dua ta falënderoj Presidencën e Hungarisë që vendosi zgjerimin si përparësi politike dhe bëri përpjekje të jashtëzakonshme për ta nxitur më tej. Na duhet zgjerimi, që BE-ja të bëhet më e fortë", ka pohuar Varhelyi.

Shqipëria ka pritur disa vjet që t'i hapë negociatat për anëtarësim. Tani, pas hapjes së kapitujve të parë, pritjet që procesi të jetë më i shpejtë.

Me hapjen e grupit të parë të kapitujve është zyrtarizuar ndarja e paketës ku Tirana ishte së bashku me Maqedoninë e Veriut. Për disa vjet vendimet janë marrë paralelisht për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa tash rugët janë ndarë.

Rruga e Shkupit drejt BE-së vazhdon të jetë e bllokuar nga Bullgaria për shkak të mosmarrëveshjeve dypalëshe.

Lidhur me ndarjen e rugës evropiane të Tiranës dhe Shkupit, Rama shprehu keqardhje. "Ndiem në siklet sepse më duhet të mendoj për poshtërimin e Maqedonisë së Veriut që u detyrua të ndryshonte edhe emrin për t'u futur në këtë proces. U qëndroj të njëjtave gjëra që kam thënë për miq tanë bullgarë, sepse historia nuk mund të jetë arsyeja për t'i ndaluar bisedimet e anëtarësimit për asnjë vend", ka deklaruar Rama.

Arsyeja e ndarjes së Shqipërisë në këtë rrugëtim drejt BE-së është se Maqedonia e Veriut nuk e ka përmbushur kushtin e vendosur nga Bullgaria, që të përfshijë në preambulën e Kushtetutës minoritetin bullgar. Ky kusht është futur në kornizën negociuese që Parlamenti maqedonas votoi në korrik të vitit 2022, propozim që njihet edhe si "propozimi francez". Vendimi për hapjen e kapitullit të parë u mirëprit nga presidenti shqiptar Bajram Begaj, i cili tha se mbush me shpresë shqiptarët për realizimin "e ëndrrës së kahershme 'E duam Shqipërinë si gjithë Evropën'".

Shqipërinë e ka uruar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo ka theksuar se Shqipëria, Kosova dhe vendet e tjera demokratike të rajonit duhet të vazhdojnë të bëjnë përparim në rrugën evropiane, që është thelbësore për të siguruar paqe të qëndrueshme dhe stabilitet jo vetëm për rajonin, por gjithë Evropën. "Urime Shqipërisë për arritjen e një momenti historik të madh në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në BE! Hapja e

kapitujve të anëtarësimit në BE e sjell Shqipërinë një hap më pranë një të ardhmeje më të ndritshme dhe më të begatë për të gjithë qytetarët e saj", ka shkruar Osmani në rrjetet sociale.

Ali Ahmeti përgëzon shqiptarët dhe Ramën: Evropa, alternativa e vetme për ne

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ka komentuar hapjen e negociatave midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian të kapitullit të parë negociues. "Lajm i jashtëzakonshëm nga Luksemburgu për Shqipërinë, shqiptarët dhe gjithë rajonin e Evropës juglindore. I përgëzoj përzemërsisht të gjithë shqiptarët, kryeministrin Edi Rama dhe gjithë ekipin që punoi palodhshëm drejt hapjes së kapitullit të parë negociues. Uroj që Shqipëria të punojë fort në drejtim të realizimit të objektivit për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2030. S'ka se si mos të përmend dëshpërimin që Maqedonia e veriut nuk është sot në krah të Shqipërisë për arsye të bllokimit të rrugëtimin tonë evropian si pasojë e mos zbatimit të kornizës negociuese të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Maqedonia e veriut. Ne duhet bërë çmos që të sigurojmë dhe vulosim të ardhmen evropiane për qytetarët tanë duke demonstruar lidhshmëri dhe përcaktim. Alternativë tjetër, nuk kemi! Evropa është rruga jonë e vetme", ka shkruar Ahmeti në profilin e tij zyrtar në "Facebook".

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 TETOR - Shqipëria ka hapur të martën kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën e përbashkët për medie me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szijjarto, në Luksemburg, e vlerësoi historik këtë çast. "Hapja e kapitujve përbën arritje të madhe dhe shënon gurthemel historik në rrugëtimin e përbashkët. Çdo sukses që shënon Shqipëria në procesin e BE-së duhet të shihet si hap për të gjithë rajonin. Për Shqipërinë nuk ka tjetër të ardhme", ka theksuar Rama, duke shtuar se shqiptarët nuk mund të kenë një plan B kur vjen fjala për liritë individuale, sundimin e ligjit dhe demokracinë funksionale. "Historia na ka mësuar në mënyrën më të vështirë se kjo nuk mund të gjendet dhe madje as të

garantohet jashtë sferës së BE-së. Këto janë A-ja, B-ja dhe C-ja e mënyrës së jetesës evropiane. Zgjedhja e një alternative ndaj anëtarësimit të plotë në BE do të ishte të hiqje dorë nga mënyra e jetesës që më së fundi zgjedhëm pasi duruam epoka errësire nën perandori dhe regjime që na u imponuan", ka deklaruar Rama. Ai ka theksuar se Shqipëria ka përmbushur në mënyrë absolute të gjitha parakushtet për të nisur këtë fazë të anëtarësimit dhe mbetet e palëkundur në vendosmërinë e saj për t'i përmbushur të gjitha detyrimet e ardhshme. "Do ta bëjmë këtë së bashku me partnerët tanë përmes negociatave me angazhime të qarta e përmes punës së madhe", është shprehur Rama. Sipas metodologjisë së re, në procesin e zgjerimit fillimisht është hapur grupi i parë ku janë kapitujt që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Progresi në këtë fushë do të diktojë edhe përparimin në tërë procesin negociator.

Aktakuzë ndaj një personi për dhunën kundër KFOR-it në Zveçan

PRISHTINË, 15 TETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi se ka ngritur aktakuzë kundër një personi i cili dyshohet se ka qenë pjesëmarrës në protestën e dhunshme të 29 majit të vitit të kaluar në Zveçan, kur protestuesit serbë u përleshën me paqeruajtësit e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Sipas njoftimit, i pandehuri L. D. dyshohet se ka kryer veprat penale: Sulm ndaj personit zyrtar dhe pjesëmarrje në

turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm. Sipas aktakuzës, L. D. më 29 maj të vitit 2023 kishte qenë afër objektit të komunës së Zveçanit dhe "në koordinim me të pandehur të tjerë të nacionalitetit serb nga Kosova dhe Serbia, përmes përdorimit të dhunës, i kanë sulmuar dhe seriozisht i kanë kanosur ushtarët e misionit paqeruajtës të KFOR-it, si dhe disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës".

Prokuroria Speciale, po ashtu, ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit t'i vazhdohet masa e paraburgimit deri në epilgun e çështjes penale kundër tij. Deri më tani janë arrestuar disa persona për ngjarjet e 29 majit në Zveçan. Dhuna në Zveçan kishte shpërthyer pasi serbët lokalë patën kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan,

Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. Si pasojë e dhunës kishin mbetur të plagosur 93 pjesëtarë të KFOR-it, disa prej tyre rëndë. Në përvjetorin e sulmit ndaj KFOR-it, më 29 maj, ky mision ka kërkuar që të mbahen përgjegjës të përfshirët në sulmin e vitit të kaluar. Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet në Zveçan, duke thënë se

ato janë kryer nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq". Por, Serbia e ka mohuar një akuzë të tillë, duke akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se synonte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n". KFOR-i është përgjegjësi i tretë për sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.



Mali i Zi me më pak se 5 % të banorëve shqiptarë

PODGORICË, 15 TETOR - Në Mal të Zi 41.1 për qind e qytetarëve deklarohen malazezë, ndërsa 32.9 për qind serbë, tregojnë rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë që u bë në dhjetor të vitit 2023. Ato u publikuan të martën nga Drejtoria e Statistikave në këtë vend, MONSTAT. Për krahasim, në regjistrimin e parafundit - më 2011 - 45 për qind ishin malazezë dhe rreth 29 për qind ishin serbë. Të dhënat e fundit tregojnë, po ashtu, se popullsinë e Malit të Zi e përbëjnë 9.45% boshnjakë, 4.97% shqiptarë, 2% rusë dhe 1.6% myslimanë. Krahasuar me regjistrimin e parafundit, numri i shqiptarëve



duket stabil: më 2011 ishin 4.91%, apo 30 439, ndërsa tani janë 30 978.

Në regjistrimin e fundit, rreth 2.8% e popullsisë nuk u deklaruan. Në Mal të Zi jetojnë 623 633

banorë, që do të thotë 0.6% më shumë se në vitin 2011. Në pyetjen se çfarë gjuhe flasin, 36.2% thanë gjuhën malazeze, ndërsa 43.5% gjuhën serbe. Sipas fesë, qytetarët e Malit të Zi ndahen në ortodoksë - 71.1%, myslimanë - 20% dhe katolikë - 3.2%. Regjistrimi i rregullt i popullsisë në Mal të Zi duhej të bëhej në vitin 2021 por, fillimisht, u shty për shkak të pandemisë së koronavirusit. Pas saj ai u shty disa herë për shkak të mosbesimit të opozitës në atë proces. Partia Demokratike e Socialistëve shprehu vazhdimisht dyshime se qëllimi i vërtetë i regjistrimit ishte rritja e numrit të serbëve në Mal të Zi dhe ulja e numrit të

malazezëve. Për muaj të tërë forcat dhe mediet proserbe e proruse bënë fushatë, duke u kërkuar qytetarëve të deklaroheshin serbë. Fushatës iu bashkua edhe Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe, Porfirije, i cili u bëri thirrje qytetarëve të identifikoheshin si pjesëtarë të popullit serb dhe besimtarë të Kishës Ortodokse Serbe, që flasin gjuhën serbe. Krerët e kësaj kisha e mohojnë kombin malazez, duke e klasifikuar atë si pjesë të korpusit serb. Në atë kohë presidenti serb Aleksandar Vuçiq fliste vazhdimisht për rëndësinë e regjistrimit në përcaktimin e numrit të serbëve në Mal të Zi.

Serbia liron Sadik Durakun

PRISHTINË, 15 TETOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka njoftuar se Serbia ka liruar nga paraburgimi kosovarin Sadik Duraku, që ishte arrestuar më herët gjatë këtij vitit nën dyshime për krime lufte më 1999. Duraku, me shtetësi të Britanisë së Madhe dhe Kosovës, ishte arrestuar më 17 prill në vendkalimin kufitar Kroaci - Serbi

në Batrovci. "Lirohet z. Sadik Duraku nga paraburgimi në Serbi. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës njofton që është liruar z. Sadik Duraku, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Britanisë së Madhe, i cili ishte arrestuar më 17 prill 2024 në vendkalimin kufitar Kroaci - Serbi në Batrovci, nën akuzat goja për krime lufte gjatë

periudhës së luftës në Kosovë në vitin 1999. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës do të vazhdojë t'i ndjekë nga afër rastet e tilla duke njoftuar edhe bashkësinë ndërkombëtare rreth veprimeve arbitrare dhe destruktive të Serbisë të cilat bien ndesh me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", ka njoftuar MPJD.



ADOLF HITLERI: JETA, MIZORITË DHE VDEKJA E TIJ (2)

Hitleri prirej nga urrejtja dhe shkatërrimi!

Edhe në fillim të shekullit XXI vazhdojnë të jenë të hapura pyetje të ndryshme lidhur me rrethanat shoqërore, historike, politike, kulturore, psikologjike etj. të paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën botërore. Në këtë kuptim, me të drejtë shtrohen pyetjet: Cila ishte parahistoria e paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën politike? Cilat ishin parakushtet historike, kulturore etj. që mundësuan paraqitjen e nazizmit si ideologji dhe lëvizje politike dhe ushtarake? Çfarë lloj njeriu mund të planifikonte dhe të zbatonte plane dhe projekte aq vdekjeprurës për njerëzimin? Megjithatë, Adolf Hitlerit, diktatorit më të rrezikshëm të shekullit të XX, nuk i dihet varri, ndërsa në vendin e tij në Gjermani nuk ka përmendore!



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Në Vjenë Hitleri bënte jetën e një lypësi

Në pranverën e vitit 1908 Hitleri sërish u nis për në Vjenë, ku do të kalonte më shumë se pesë vjet. Në Vjenë ai mori një apartament me qira dhe banonte me mikun e tij Kubizek. Dihet se në vitin 1909, pasi më parë kishte marrë fund miqësia e tij me August Kubizekun, Hitleri, në mungesë të burimeve financiare kishte bërë me javë të rëra jetën e një lypësi rrugësh dhe kishte fjetur në parqet publike. Kjo ishte pa dyshim një sprovë e egër, sidomos për një njeri të tillë me ambicie të hipertrofizuar që prirej gjithnjë e më shumë nga urrejtja dhe shkatërrimi. Më vonë, pasi, në saje të mikut të tij të ri, Reinhold Hanich, sërish e rimori veten, Hitleri shprehi dëshirën të pranohej në Akademinë e Arteve të Bukura, por sërish pa sukses. Në maj të vitit 1913 ai mori vendimin ta braktis Vjenën dhe të shkonte në Munih, ku u regjistrua si njeri "pa kombësi". Ai vazhonte të vuante nga mospërshtatja tërësore ndaj jetës normale, por nga kjo situatë e nxori fillimi i Luftës së Parë Botërore. Tamam në atë kohë, ai që dukej endacak i përjetshëm, u shndërrua në një fanatik të një bashkësie "raciste" dhe në idealin ushtarak zbuloi një mistikë, që u bë feja e udhëheqësit totalitar. Ekzistonte një letër e datës 5 shkurt 1915, në të cilën

Hitleri tregon se nga qëndrimi i vet racist nuk kishte lëvizur asnjë çikë. Në këtë letër veç të tjerash shkruante: "Ne jo vetëm që do t'i bëjmë copa-copa armiq të jashtëm të Gjermanisë, por do ta shtypim gjithashtu edhe internacionalizmin e brendshëm. Kjo do të jetë më e rëndësishme sesa të gjitha aneksimet".

Me gjithë meritat e tij, Hitlerin nuk e bënë oficer, sepse udhëheqësit e tij e mbanin për të paaftë si komandant dhe mendonin se i mungonin cilësitë e duhura për të drejtuar. Në këtë pikë, gjithsesi, ata kishin qenë në lajthitje. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, ai u rikthye në Munih, ku fillimisht ishte roje e një kampi të robërve rusë. Kur kampi u mbyll, ai u kthye prapë në kazermë, pa ushqyer ëndrrën për tu marrë me politikë. Pas fitores së reaksionarëve, ushtria e re gjermane (Reichswehr), krijoi një zyrë që merrej me hetimin e gjendjes shpirtërore të ushtrisë dhe me spiunimin e organizatave punëtore. Hitleri u caktua aty menjëherë, por fillimisht e bëri një kurs për tu përgatitur si informator ose propagandist i ardhshëm. Edhe aty, pra në vendin e tij të ri të punës, Hitleri, midis shokëve mbante fjalime patriotike. Historiani Karl Alexander von Muller, pasi e kishte dëgjuar një ditë Hitlerin kishte thënë: "A e dini se midis nxënësve tuaj keni një orator të lindur".

Që në këtë periudhë, veçmas sapo kishte mabruar kursin dhe u bë instruktor, Hitleri kishte shfaqur ndjenjat e tij të thella dhe shumë të rrezikshme antisemitiste, duke këshilluar në një shkrim të tij të datës 8 shtator të vitit 1918, dëbimin e çifutëve.

Disa ditë më vonë, pasi eprorët e Hitlerit e kishin ngarkuar atë të hetonte çështjen e një partie

shumë të vogël nacionaliste bavareze, e që e mbante emrin Partia e Punonjësve Gjermanë, Hitleri asistoi në mbledhje. Pasi, gjatë debatit një folës ishte shprehur për shpërbërjen e Bavarisë nga Prusia, Hitleri e kishte kundërshtuar atë duke lartësuar patriotizmin gjerman. Nga kjo paraqitje, ai fitojë përkrahje të fortë, mori urdhrin të regjistrohej në parti dhe arriti të marrë dhe një pagë mujore prej njëzet marka gjermane. Shumë shpejt u emërua shef i propagandës.

Fjalimi i zjarrtë para 2000 vetëve

Në të vërtetë, Hitleri u bë menjëherë frymëzues i Partisë së Punonjësve Gjermanë. Ai bëri që të hartohej statuti i partisë dhe ai ishte statuti i Partisë Nacional - Socialiste, i përbërë nga njëzetë e pesë pika, që mbeten të pandryshueshme.

Fyhreri i ardhshëm dhe shpejt prova të zellit të një organizatori, për të cilin në Partinë e Punonjësve Gjermanë kishte shumë nevojë.

Më 24 shkurt 1920, Hitleri foli përpara dy mijë vetëve, të cilët e dëgjuan për dy orë e gjysmë. Në atë mbledhje ai e shpalli programin dhe statutin e partisë, si dhe emrin e saj të ri - Partia Nacional - Socialiste e Punonjësve Gjermanë. Emri i

Hitlerit filloi të bëhej i njohur në Munih. Atë e konsideronin si fenomen. Në prill të vitit 1921, pas kthimit nga një udhëtim në Berlin, më në fund u lirua nga ushtria për tu rikthyer në jetën civile. Në qershor të vitit 1922, e gjejmë në Vjenë në një konferencë patriotike kushtuar bashkimit gjermano-austriak, ai qe oratori kryesor.

Në fund të shtatorit 1923, Hitleri e përshkruante misionin e nacional - socialistëve me këto fjalë mahnitëse: "Dita për të cilën kjo lëvizje është formuar po afron...Ka ardhur çasti kur lëvizja nacional - socialiste do të fillojë marshimin triumfal për shpëtimin e Gjermanisë...Ne nuk jemi krijuar për votime, por për tu hedhur në betejë në momentin më kritik, kur populli ynë të shohë i llahtaritur dhe gjithë drithërimë përbindëshin e kuq, që vërsulet mbi të...".

Në nëntor të vitit 1923, megjithatë pas një përpjekje të pasuksesshme për grushtet, Hitleri, i akuzuar për tradhti të lartë, së bashku edhe me dyzet bashkëpunëtorë të tjerë, u burgos në kështjellën bavareze të Landsbergut.

Gjyqi kundër tij u hap në fund të shkurtit të vitit 1924 dhe përfundoi me fitoren e Hitlerit, i cili u lirua në dhjetor të vitit 1924.

Posa doli nga burgu, Hitleri e

filloi marshimin e tij drejt pushtetit. Fillimisht duke i forcuar radhët e partisë e cila ndodhej në gjendje të vajtueshme. Ringjallja e partisë Nacional - Socialiste fillimisht ishte e ngadalshme. Në këtë periudhë, pra në fund të vitit 1925 kur partia kishte vetëm 27.000 anëtarë, veçohet anëtarësimi në te i Joseph Goebelsit, një propagandist gjenial, tek i cili Hitleri kishte vënë re dhuntitë e jashtëzakonshme të tij.

Në vitin 1928 rruga e Hitlerit për në Berlin tashmë ishte hapur. Zgjedhjet e përgjithshme të majit 1928 u dhanë mundësinë dymbëdhjetë deputetëve nazistë të hyjnë në Reichstag dhe Goebelsi u zgjodh deputet i Berlinit. Një ditë pas zgjedhjes deputet i Berlinit, Goebelsi, në gazetën e vet "Anfriff" shkruante dhe kërcënonte me fjalët: "Ne po hyjmë në Reichstag në mënyrë që, në arsenalin e demokracisë, të furnizohemi me armët tona... Ne po vijmë këtu si armiq. Ne jemi ujçer që futemi në vathë. Kini kujdes".

Ndërkohë që papunësia në Gjermani po rritej me shpejtësi. Në fund të vitit 1930 kishte mbi tre milionë të papunë, kurse në fund të vitit 1931 katër milionë, ndërsa në verën e vitit 1932 papunësia arriti shifrën mbi gjashtë milionë. (Vijon)



Heshtja ndaj Speciales, rekomandim apo tradhti?!

Shkruan: Sali BISLIMI

E kam vështirë ta kuptoj heshtjen tënde të mjerë Kosovë.

President, ku na mbetën miqtë, i hëngri ujku apo u bënë ujç? Kujt i shkon më së shumti përshtati kjo heshtje? Atyre që të fitojnë luftën kundër UÇK-së, që pastaj të zemërohen me zërin e qyqes.

Nëse heshtja është rekomandim atëherë kemi të bëjmë me shkëlqen e drejtave të njeriut, nuk është aspak demokratike. Kjo situatë komplekse ngre pyetje thelbësore në lidhje me drejtësinë ndërkombëtare, ekuilibrin midis sigurisë dhe të drejtave të njeriut dhe kuptimin e drejtësisë pas konfliktit, veçanërisht në një kontekst ku tensionet historike

mund të ndikojnë në perceptimet dhe opinionet.

Angazhimi i gjykatës për të prodhuar dëshmitarë është devijim i drejtësisë, ata dëshmitarë nuk janë kundër Hashimit, më shumë janë kundër Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Kjo aventurë e rrezikshme e ndërtuar mbi thashethemet shkaktoi një dhimbje ndaj të pafajshmit president Thaçi, vetëm për t'i kënaqur hipokritët vendas dhe ndërkombëtarë që ishin kundër pavarësisë së Kosovës.

Armiaqë të lirisë së Kosovës turqit dhe serbët qëndruan gjatë tek ne dhe padyshim që mbollën farën e tyre që ende nuk shkëputen ëndrrat për kthimin e tyre.

Kjo luftë speciale kundër trashëgimisë së UÇK-së dhe sot të Forcës së Sigurisë që të mbeten pa bukë është dëshmia më e mirë për t'i thënë stop degjenerimit politik në shtetin tonë të fituar me shumë djers dhe dhimbje.

Por ju të politikës kush jeni? Deri kur abuzoni me vlerat e shtetit tonë? Ku jetojnë familjet e juaja? A e keni historinë në tokën e Kosovës, nëse po ku i keni varret e të parëve tuaj!

Kosova nuk duron padrejtësi. Kjo tokë ka rrezuar kralja dhe sulltana. Edhe juve do t'ju heqë qafesh. Të gjithë juve fetarë dhe politikanë që jeni kundër vlerave perëndimore të shtetit të ri. Drejtësia e mirëfilltë demokratike që ndërton paqen duhet ta kthejë së shpejti presidentin Thaçi në atdhe.



Politologu Albinot Maloku: Qeveria e shkeli edhe parimin e reciprocitetit

PRISHTINË, 15 TETOR - Politologu Albinot Maloku ka reaguar në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për heqjen e regjimit të vizave për shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Ai thotë se qeveria e shkeli parimin e reciprocitetit, duke u treguar kreative në një situatë krejtësisht të paleverdishme në aspektin ndërkombëtar për Republikën e Kosovës. "Këtu i kemi dy shpjegime! Shpjegimi i parë është që garnitura aktuale drejtuese, qeverisëse e Republikës së Kosovës, ka prodhuar më shumë sesa që duhet situata refuzuese dhe kemi marrë vetëm ne presione për gjithçka. Kjo ka rrjedhur si pasojë e këtij zryshiti të garniturës drejtuese politike, që në krye të herës kur erdhën në shprehje të qeverisin vendin kanë ngelelur në minimum mundësitë



që të shfrytëzohen alternativat që të përdoren ato si presione saktësisht ndaj Bosnjë-Hercegovinës. Ndërsa tani e kemi situatën kur kemi zbrapsje nga parimi thelbësor i kësaj qeverie që ka qenë reciprociteti. Mirëpo tanimë kjo nuk është befusuese me këtë garniturë që e bëma dhe e

thëna kanë dallim shumë të madh", u shpreh Maloku në emisionin "Ditari" në Tëvël. Politologu Maloku kur flet për sukseset e mossukseset e procesit të Berlinit thotë se ky dhjetëvjeçar i procesit të Berlinit, e sidomos këto vitet e fundit, janë pasqyrim i gjendjes së Bashkimit Evropian.

Tutje ai shton se Berlinit, posaçërisht BE-ja, nuk e ka një vizion të qartë se si t'u qaset vendeve të Ballkanit Perëndimor, mirëpo thotë se "kjo ka mundur të jetë më ndryshe sikur faktori ndërkombëtar perëndimor nuk do të kalkulonte më shumë në anësinë gjeopolitike të Serbisë sesa në demokratizimin e mirëfilltë të shoqërive dhe politikave, sidomos të serbëve në Ballkan".

Ai shpjegon se kjo qasje ka lejuar këtë hapësirë që shumë gjëra të shkojnë edhe pavrejtshëm nga ana e faktorit perëndimor dhe të jenë irrituese për ata të cilët dëshirojnë njëanshëm të angazhohen në jetësimin e asaj çfarë është vendosur në letër, siç është rasti me Kosovën që, sipas tij, me vendosjen e heqjes së vizave për Bosnjë-Hercegovinën, si veprim kreativ, kishte për ta

pasur peshën e vet në një rrethanë tjetër politike. "E jo tani kur edhe vetë takimi në Procesin e Berlinit ka mundur të ndodhë pa Kosovën nëse ajo nuk do të hiqte dorë nga disa vendime të veta të cilat nuk prodhuan asgjë veç këtij takimi. Dhe këtë lëshim dore nga ikja e parimit të reciprocitetit që ka qenë tentim i qeverisjes aktuale për ta fuqizuar maksimalisht, që për mua ka qenë shumë i shëndetshëm por, fatkeqësisht, qeveria nuk po e mban asnjërin nga këto parime që në politikën rajonale e kanë pasur efektin e vet. Sot kemi situatën ku pa respektuar parimin e reciprocitetit, duke u treguar kreativ në një situatë krejtësisht të paleverdishme në aspektin ndërkombëtar për Republikën e Kosovës, qeveria merr vendime të tilla", ka theksuar politologu Albinot Maloku.

Kryetari i SBASHK-ut: Ministri Murati kur flet për pagat nuk ka pse krenohet, po duhet të skuqet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka kritikuar ministrin e Financave, Hekuran Murati, për rritje pagash. "Ministri Murati nuk u ndal se lavdëruari për do farë rritje pagash në Kosovë edhe gjatë së dielës së kaluar. Ai deklarimin e vet e mbështeti edhe në ASK-në për t'u dukur se po thotë diçka, por ASK-ja e quan ngritje page edhe nëse ndodh një rritje ironike si ajo në arsim prej vetëm 28 eurosh në janarin e këtij viti sepse Murati e ngriti, pa pyetur askënd për vlerën e koeficientit të pagave nga 105 në 110 euro", ka thënë Jasharaj.

Ai ka theksuar se ministri Murati

këto deklarime i bën për të krijuar një përshtypje se gjoja në Kosovë ka pasur rritje pagash. "Kështu ai dëshiron që në opinion, së paku tek ata që i besojnë, t'i prezantoj si të paarsyeshme kërkesat legjitime të SBASHK-ut e të sindikatave të tjera për rritje të vlerës së koeficientit për së paku 30 %. Ministri Murati është i njohur për qasje të gabuar ndaj dialogut dhe me qasje edhe armiqësore ndaj sindikatave, veçmas ndaj SBASHK-ut, por realiteti i tregon se në vend që të krenohet se gjoja paska pasur rritje të pagave, ai duhet të skuqet kur flet për çështjen e pagave. Ministri duhet ta di se ngritje të lartë të çmimeve të artikujve elementarë të jetës kanë ndodhur vazhdimisht e rritje të dukshme të pagave, që do të mundësonin përballje më të lehtë me këto



çmime, nuk ka pasur. Ministri duhet t'i lëshë zënat e deklaratat plot krekosje e ta shoh realitetin, i cili është i hidhur", është shprehur Jasharaj, duke shtuar se ministri Murati duhet t'i lexojë statistikën edhe të vendeve rreth nesh. "Në

ato shtete çmimet e artikujve elementarë janë si te ne, apo pak më të larta, por qeveritë atje u janë përgjigjur situatave dhe kanë bërë ngritje të dukshme të pagave në arsim e në sektorë të tjerë. Ministri Murati le ta hedhë shikimin drejt

Shqipërisë dhe do të shohë se kjo që po them unë është e vërtetë. Mësuesit atje i është bërë paga 900 e më shumë euro e mos të flasim për pagën e mësuesit në Mal të Zi. Ministër Murati, ti me deklaratat tuaja për ngritje pagash mund të marrësh ndonjë duartrokitje nga ata që të besojnë verbërisht, por mijëra të punësuar në sektorin publik e dinë të vërtetën dhe janë shumë të mllefosur në ty sepse ata mezi po e lidhin fillimin e muajit me fundin e tij dhe janë shumica në kredi. Mos harro se këtë vit ke bërë lëvizje të pagës në arsimin parauniversitar për vetëm 28 euro dhe këtë punëtorët e arsimit e kanë konsideruar ngritje ironike e nënçmuese e pagës. Pra, ministri Murati kur flet për pagat nuk ka pse krenohet, po duhet të skuqet", ka thënë Murati.

Dalin pensionet me rritjen prej 20-përqindësh

PRISHTINË, 15 TETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar të martën se ka filluar ekzekutimi i pensioneve për muajin tetor, duke përfshirë rritjen prej 20 % për disa skema pensionesh. Në një postim në rrjetet sociale, Murati ka theksuar se duke filluar nga ky muaj, rritja do të aplikohet për të gjitha

llojet e pensioneve, përfshirë: Pensionet për aftësi të kufizuara, pensionin për personat e verbër, pensionin për paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pensionin invalidor të punës, pensionin familjar, pensionin e parakohshëm të Trepçës. “Ky është një hap i rëndësishëm për t’i mbështetur ata që kanë

kontribuar në shoqërinë tonë dhe për t’u ofruar ndihmë atyre që kanë nevojë”, ka thënë Murati. Ai ka theksuar se ky vendim është pjesë e angazhimit të qeverisë për ta përmirësuar mirëqenien e qytetarëve. Qeveria e Kosovës ditë më parë mori vendim për rritjen e pensioneve prej 20-përqindësh.



Marrëveshjet e CEFTA-s dhe plani i ri i veprimit për tregun e përbashkët rajonal në fokus në Samitin e 10 të Procesit të Berlinit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Berlin, 15 tetor - Udhëheqësit e Procesit të Berlinit nga Ballkani Perëndimor dhe disa shtete anëtare të BE-së u mbledhën në Berlin për ta shënuar dhjetëvjetorin e Procesit të Berlinit dhe për të diskutuar iniciativa kyçe që synojnë nxitjen e integritimit ekonomik, lidhshmërisë dhe qëndrueshmërisë.

Në samitin e organizuar nga kancelari gjerman Olaf Scholz, mori pjesë edhe drejtoresha e përkohshme e Sekretariatit të CEFTA-s, Danijela Gaceviq. Gjatë samitit marrëveshjet e CEFTA-s u theksuan si një arritje historike që do ta mundësojë

zbatimin e suksesshëm të planit aktual të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM). Drejtoresha e Përkohshme e Sekretariatit të CEFTA-s, Danijela Gaceviq, ka shprehur mirënjohjen ndaj Gjermanisë dhe pjesëmarrësve të tjerë të Procesit të Berlinit për mbështetjen e tyre në miratimin e marrëveshjeve të CEFTA-s.

Duke shpjeguar rëndësinë e tyre, ajo shtoi: “Secila nga këto marrëveshje sjell një sërë përfitimesh të prekshme për popujt dhe bizneset tona, pa të cilat mozaiku i Tregut të Përbashkët Rajonal nuk do të ishte i plotë. Por ky është vetëm fillimi. Sot udhëheqësit ishin të qartë se duan më shumë rezultate dhe CEFTA është e vendosur t’i



ofrojë ato”. Duke u bazuar në përparimin e bërë gjatë katër vjetëve të fundit, udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor miratuan një Plan të Ri të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal për vitet 2025-2028, i cili përcakton drejtimin për

përmirësimin e tregtisë, mobilitetit dhe investimeve në të gjithë rajonin dhe integrimin me Tregun e Vetëm të BE-së. Plani i ri katërvjeçar është i ndarë në 6 shtylla, nga të cilat 3 do të zbatohen nga CEFTA: lëvizja e lirë e mallrave, lëvizja e lirë e

shërbimeve dhe masat horizontale të tregtisë. Ky plan synon ta shfrytëzojë potencialin e rajonit duke nxitur tregtinë, investimet dhe duke hapur derën për integrimin e përsheptuar në Tregun e Vetëm të BE-së. Përveç zgjerimit të tregtisë dhe tregut, Samiti trajtoi çështje urgjente që lidhen me Agjendën e Gjellbër dhe lidhshmërinë energjetike. Samiti përfundoi me një konferencë të përbashkët për shtyp ku morën pjesë kancelari Olaf Scholz, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe figura të tjera kyçe, duke sinjalizuar një mbështetje të fortë të BE-së për përpjekjet e integritimit dhe bashkëpunimit të rajonit.

KMDLNj: Trajtim jonjerëzor dhe degradues i pensionistëve

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se pensionistëve po iu bëhet jonjerëzor dhe degradues. “Pensionistët, pavarësisht nga mosha apo gjendja shëndetësore janë të detyruar që në çdo gjashtë muaj të paraqiten në pikat e caktuara për të dëshmuar se janë gjallë. Për një numër të pensionistëve kjo paraqitje paraqet problem të madh prandaj edhe e humbin pensionin shkaku i moslajmërit. Para pikës së paraqitjes, sidomos në qendër të Prishtinës, kalimtarë i rastit



përballet me situata të rënda ku të moshuar në karroca, të shoqëruar apo edhe të vetmuar bëjnë përpjekje të futen brenda apo

qëndrojnë në vetura”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se skenat janë të llatharshme dhe fyese për

dinjitetin njerëzor dhe në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut për këtë komunitet jashtëzakonisht të cenueshëm. “KMDLNj edhe më herët ka reaguar kundër kësaj sjelljeje degraduese dhe diskriminuese ndaj pensionistëve duke kërkuar nga institucionet përgjegjëse të bëjnë zgjidhje më të përshtatshme por se asgjë nuk është punuar për këtë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës është dashur ta trajtojnë seriozisht këtë çështje, sidomos pas reagimeve të Avokatit të Popullit dhe KMDLNj-së, pasi që është në mandatin e tyre dhe janë të detyruar të mbrojnë të drejtat e njeriut”, është thënë në këtë reagim. Sipas KMDLNj-së, nëse


institucionet përgjegjëse nuk kanë kapacitet të trajtojnë këto raste përmes vizitave verifikuese të rasteve që kanë vështirësi apo të pamundur të paraqiten në pikat e verifikimit, atëherë, përmes thirrjes publike duhet të angazhohet një kompani që do ta kryente këtë punë. “Apo mund të ndihmohet edhe nga vullnetarët student ose nxënës të shkollave të mesme. Sido që të bëhet, institucionet përgjegjëse duhet ta shlyejnë këtë njollë turpi ndaj një gjenerate, dikur shumë kontribuuese, tash në margjinat e interesit institucional për një trajtim dinjitoz, në përputhje me ligjin dhe të drejtat e njeriut”, është theksuar ndër të tjera në reagimin e KMDLNj-së.

Dogana kap sasi ari të padeklaruar në Aeroport

PRISHTINË, 15 TETOR - Në një operacion të suksesshëm të kontrollit doganor, Dogana e Kosovës ka ndaluar një sasi të padeklaruar prej 1 kg ari, me pastërti prej 14 karatësh. Gjatë kontrollit të udhëtarëve, imazhet e skenerëve treguan indikacione për mallra të padeklaruar brenda një çante. Pas hapjes së çantës u zbuluan mallrat e fshehura së

bashku me dokumentacionin përkatës që shoqëronte mallrat. Pas një vlerësimi të hollësishëm nga Dogana e Kosovës, u konstatua se vlera reale e arit të ndaluar është 59,294.12 euro. Rasti është duke u trajtuar në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Hetimeve të Doganës së Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit, për t’i

analizuar të gjitha detajet dhe për t’i ndërmarrë veprimet e duhura ligjore ndaj individëve përgjegjës. Përmes kontrolleve të vazhdueshme dhe bashkëpunimit me institucionet relevante, Dogana e Kosovës luan rol kyç për mbrojtjen e integritetit të kufijve dhe tregut të Kosovës.



Diaspora shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore

Kur Said Kryeziu mbërriti në Berat, u takua me Enver Hoxhën dhe Julian Amery thotë që Enver Hoxha i ofroi postin e nënkryetarit të shtetit, por Said Kryeziu e refuzoi këtë post duke i thënë Enver Hoxhës: “Ti më vrave mikun dhe këshilltarin Lllazar Fundo dhe si mund të bashkëpunoj me ty”? Më vonë, anglezët e morën Said Kryeziun me aeroplan ushtarak nga Berati dhe e dërguan në Bari të Italisë. Said Kryeziu ishte i vetmi njeri, për të cilin anglezët ndërhyjnë për ta shpëtuar nga komunistët



Shkruan: Gani PEROLLI

Një pjesë e konsiderueshme e atyre që ishin angazhuar në lëvizje politike në Shqipëri e Kosovë dhe ata që patën shërbyer në pozita qeveritare të okupatorëve, u larguan fill pas Luftës së Dytë Botërore në mënyra të ndryshme. Disa nga ata vazhduan rezistencën ndaj regjimit të ri diktatorial dhe disa qëndruan për një kohë në ilegalitet, ndërkohë që kaluan ilegalisht në Greqi e Jugosllavi.

Njëri nga ata ishte Said Kryeziu, i cili u arrestua nga komunistët në Kosovë së bashku me majorin Simcox dhe Lllazar Fundon. Arrestimi i tyre ndodhi më 20

Fundon ta mbajnë andej, ta torturojnë e pastaj ta pushkatojnë. Kështu edhe ndodhi. Lllazar Fundon e lidhën dhe e tërhoqën zvarrë mbas kalit të Shefqet Peçit. Kur mbërritën në Kolesjan të Lumës, më saktë në shtëpinë e Miftar Spahisë, Fundon e torturuan brutalisht, pastaj e pushkatuan. Kur Said Kryeziu mbërriti në Berat, u takua me Enver Hoxhën dhe Julian Amery thotë që Enver Hoxha i ofroi postin e nënkryetarit të shtetit, Said Kryeziu e refuzoi këtë post duke i thënë Enver Hoxhës: “Ti më vrave mikun dhe këshilltarin, Lllazar Fundo, dhe si mund të bashkëpunoj me ty”? Më vonë, anglezët e morën Said Kryeziun me aeroplan ushtarak nga Berati dhe e dërguan në Bari

Kombëtare Shqiptare e Bujqëve dhe Katundarëve. Komiteti konsiderohej si qeveri në mërgim nga aleatët anglo-amerikanë. Kur Komiteti u zgjerua në vitin 1953, Blloku Kombëtar Independent prapë nuk u pranua si parti në Komitet, por u pranuan vetëm disa nga ata si Ismail Vërllaci, Ndue Gjormarkaj e disa të tjerë.

Komiteti “Shqipnija e Lirë” kishte dy qëllime: bashkimin kombëtar dhe bashkimin e diasporës shqiptare. Në rast të çlirimit të Shqipërisë nga regjimi komunist, Komiteti “Shqipnija e Lirë” do të shkonte në Shqipëri si qeveri provizore derisa të organizoheshin zgjedhjet e lira, ndërkohë që edhe anëtarët e Komitetit do t'i shpallnin kandidaturnat e tyre për qeverinë e ardhshme.

Më 29 gusht të vitit 1949, Qeveria

jugosllave botoi një artikull në “New York Times” dhe paralajmëroi se ishte formuar Komiteti për ndërrimin e Qeverisë në Shqipëri dhe se ky komitet kryesohet nga Gani Bej Kryeziu, së bashku me Bajram Bajraktarin, vëllain e Muharrem Bajraktarit, si nënkryetar. Anëtarët tjerë të këtij komiteti sipas artikullit jugosllav ishin edhe Cen Elezi së bashku me djalin e tij, Gani Elezi, pastaj Dan Kaloshi e të tjerë. Sipas informatave që dolën më vonë, doli të jetë e vërtetë që Qeveria jugosllave i kishte propozuar Gani Kryeziut kryesinë e shtetit shqiptar, të cilin ai e refuzoi kategorikisht duke ju shpjeguar më vonë shokëve të burgut dhe duke ju thënë: “Më mirë në vorr se sa horr”.

Pas formimit të Komitetit kombëtar “Shqipnija e Lirë”, Jugosllavia

në vitin 1950 themeloi një komitet të saj, kinse për të zëvendësuar Qeverinë e Enver Hoxhës. Në këtë komitet figuronin emrat e Apostol Teneftit, kryetar, pastaj emrat e Tajar Hatipit e Nik Sokolit, nënkryetarë, si dhe emri i Lutfi Spahisë. Qendra e këtij komiteti në fillim ishte në Prizren, pastaj në Prishtinë.

Gjatë qëndrimit tonë gjashtëvjeçarë në Jugosllavi, askush nga emigrantët shqiptarë nuk shprehej për ndonjë identifikim me ndonjë parti shqiptare që ekzistonte në Perëndim. Këto tendenca lindën posa kaluam kufirin e Jugosllavisë për në Itali. Së pari mbërritëm në kampin e refugjatëve në Triestë kah fundi i vitit 1954. Ne ishim grupi i parë familjar që na arrestuan në kufirin jugosllavo-italian në fund të vitit 1954 dhe na dërguan në kampin e përqendrimit në Gerovo në Kroacisë. Më 15 dhjetor të vitit 1955, Qeveria komuniste e Shqipërisë u pranua në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, përmes një tregtie që shtetet perëndimore realizuan me Bashkimin Sovjetik, siç e shpjegonte Tajar Zavalani në Radio “Londra” në atë kohë. Si rezultat i këtij vendimi, Komiteti kombëtar “Shqipnija e Lirë” u shpërbë, pasi nuk mund të njiheshin dy qeveri një të njëjtën kohë.

Më vonë u formua një grup nga pesë persona, kinse independentë, dhe ata ishin Rexhep Krasniqi, Ndue Gjormarkaj, Nexhat Peshkëpia, Vasil Gërmenji dhe Sotir Avrami. Rexhep Krasniqi bënte pjesë në grupin e Xhafer Devës, Ndue Gjormarkaj ishte nënkryetar i Bllokut Independent, derisa Nexhat Peshkëpia ishte në Ballin Kombëtar. Ky komitet nuk pati kurrfarë jehone. Këta e adoptuan emrin e Komitetit të mëparshëm, sepse edhe nuk kishte kush t'i kundërshtonte. Ky grup nuk kishte asnjë mandat politik apo kombëtar dhe mandati i tij ishte mbushja e formulareve për migrim. Ky grup gati e zbrazi Malin e Zi nga shqiptarët, duke sponsorizuar ardhjen e tyre në Shtetet e Bashkuara të Amerikës! /Telegrafi/



shtator të vitit 1944, në Dobërdje të Malësisë. Majori Simcox, ishte i atashuari britanik tek Lëvizja Kryeziu. Njeriu që i arrestoi ishte Ismet Shaqiri, por në atë grup ishte edhe Fadil Hoxha, Shefqet Peçi etj. Pas arrestimit, Simcoxi pati zhvilluar një bisedë me Fadil Hoxhën, duke kritikuar qëndrimin e tij dhe duke i thënë që çdo kërcënim ndaj vëllezërve Kryeziu do të konsiderohej krim ndaj Britanisë së Madhe. Ato armë që Gani Kryeziu ua kishte shpërndarë komunistëve të Kosovës, me urdhrin e britanikëve u kthyen kundër tyre.

Kur u arrestuan këto personalitete, komunistët u thanë atyre që i kërkonte gjeneral Dali Ndreu që të takoheshin, por kjo nuk ishte e vërteta, sepse urdhri ishte nga Enver Hoxha që ta takonte Said Kryeziun në Berat, ku edhe mbahej Plenumi i parë i Partisë Komuniste Shqiptare. Në anën tjetër, ai kishte dërguar urdhër përmes Lirie Gegës, që Lllazar

të Italisë. Said Kryeziu ishte i vetmi njeri, për të cilin anglezët ndërhyjnë për ta shpëtuar nga komunistët.

Migrimi i parë i personaliteteve politike shqiptare ndodhi në Greqi që nga viti 1945. Kur kolonel Muharrem Bajraktari mbërriti në Greqi me grupin e tij në fund të vitit 1946. Në kampin e Haxhiqirjakos ishin rreth 900 emigrant shqiptarë. Po ashtu edhe në kampin e Lavrios ishin rreth një mijë emigrantë shqiptarë. Grekët i keqtrajtonin vazhdimisht emigrantët shqiptarë, pasi kishin pretendime shoviniste ndaj Shqipërisë së Jugut.

Komiteti kombëtar “Shqipnija e Lirë”, u themelua në Paris më 26 gusht të vitit 1949 nga Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Said Kryeziu, Zef Pali dhe Nuçi Kota. Këta ishin edhe Këshilli Ekzekutiv i Komitetit. Në Komitetin “Shqipnija e Lirë”, morën pjesë tri parti politike: Balli Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit dhe Lidhja

EXILES MAP FIGHT ON TIRANA REGIME
By C. L. SULZBERGER Special to THE NEW YORK TIMES
 New York Times (1947) Current Aff.; Aug. 29, 1949; Professor Historical Newspapers The New York Times (1851-2004)

EXILES MAP FIGHT ON TIRANA REGIME
Refugees Gird for Overthrow of Hoxha, Who Also Faces Internal Opposition

By C. L. SULZBERGER
Special to The New York Times

BELGRADE, Yugoslavia, Aug. 28—Two committees of refugees from Premier Enver Hoxha's Albanian "people's republic" have been formed in Yugoslavia with the avowed purpose of overthrowing eventually the Tirana regime and returning to their homeland.

It is understood that the nucleus of this anti-Hoxha movement consists of 3,000 Albanian émigrés established in a political committee with headquarters at Prizren and a strategy committee with headquarters at Peç.

The leader of this movement is Gani Bey Kryeziu, a powerful tribal chieftain from Northern Albania, where a somewhat feudal system of clans still prevails among the sturdy mountaineers.

Mr. Kryeziu was a guerrilla leader during World War II but refused to associate himself either with Premier Hoxha's Albanian Partisan movement or that of Marshal Tito's Yugoslavia. After the war he fled to Yugoslavia. Last autumn he went to Prizren to confer with the large Albanian minority of the Yugoslav Kosovo-Metohia area, and organize a considerable emigré colony from those who had fled across the mountain passes dividing the two countries.

Mr. Kryeziu now has obtained the support of a considerable list of men with extensive influence among the Albanian people. These include Cen Elezi, a north Albanian tribal chief, and his son, Gani. Both Cen and Gani were for a while members of General Hoxha's National Liberation Front, but quit in 1946.

Other supporters are Bajram Bajraktari, Don Kaloshi and Caf Bey Ulqinaku. Bajram Bajraktari is a brother of the wartime anti-Communist guerrilla leader, Col. Muharrem Bajraktari, who is now a refugee in Athens. Mr. Kaloshi is a northern tribal leader with great influence among the Catholic population in the vicinity of Scutari. Mr. Ulqinaku is a former member of the wartime Albanian regency.

It is thus evident that the refugee committees based here have a fairly broad "popular front" basis that does not appeal solely to one or two groups. At the same time, it is learned here that Premier Hoxha's personal authority in Albania gradually is weakening.



As a result of the intervention of the Soviet Minister in Tirana, the actual boss of the country, Dimitri Chivakin, Premier Hoxha was forced to promote Maj. Gen. Mehmet Shehu to colonel general, a rank previously held only by Premier Hoxha. This took place on July 10.

It is believed that Mr. Chivakin has felt Premier Hoxha is not as trustworthy as General Shehu, who appears to be easing his boss out of the picture gradually.

He is not a dynamic figure. In May of this year he was openly pessimistic about the future of himself and his regime. A year previously he was almost overthrown by Lieut. Gen. Koci Xoxo, who was executed this year. At that time Premier Hoxha, far from showing much fight, sounded out a certain Western power about the possibilities of sanctuary. He is on record as indicating the view that his regime has been saved thus far only by the Cominform quarrel.

General Shehu, on the contrary, is one of the few pre-war Albanian Communists. He commanded a battalion of the International Brigade during the Spanish Civil War and was later a capable Partisan leader. After World War II he studied at the Voroshilov Military Academy in Moscow. He is clearly trusted by the Kremlin.

Reproduced with permission of the copyright owner. Further reproduction prohibited without permission.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova triumfon ndaj Qipros në 'Fadil Vokrri'

PRISHTINË, 15 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka mposhtur Qipron në ndeshjen që është zhvilluar sonte në stadiumin "Fadil Vokrri", me rezultat 3-0. Kjo është fitorja e tretë radhazi për "dardanët". Me këtë sukses, Kosova përforcon vendin e dytë të Grupit 2 të Ligës C me 9 pikë, teksa Rumania kryeson me 12 pikë.

Ndeshja ndaj Qipros tregoi një dominim të plotë të ekipit të udhëhequr nga selektori Franco Foda, me një paraqitje të fuqishme që nuk la dyshime për epërsinë e Kosovës. Goli i parë erdhi në minutën e 30-të, kur kapiteni Amir Rrahmani dërgoi topin në rrjetë pas një lëvizjeje të shkëlqyer, duke kaluar nëpër mbrojtjen kundërshtare dhe mposhtur portierin. Ai u asistua nga Florent Muslija, i cili u fut në lojë herët në minutën e 16-të, pas largimit të Milot Rashicës për shkak të një lëndimi. Në pjesën e dytë, Kosova vazhdoi të kontrollonte lojën dhe dyfishoi epërsinë me një gol të Ermal Krasniqit në minutën e 52-të. Fitorja u vulos me golin e tretë nga zëvendësuesi tjetër Emir Sahiti në minutën e 71-të, pas një reagimi të shpejtë ndaj pritjes së portierit qipriot që ndaloi fillimisht gjuajtjen e Albion Rrahmanit. Edhe pse Kosova pati disa raste të tjera për të shënuar, rezultati përfundimtar mbeti 3:0. Ndërkohë, Qipros iu anulua një gol për pozicion jashtë loje. Kosova do të përballet me dy ndeshje vendimtare në nëntor për edicionin e katërt të Ligës së Kombeve. Më 15 nëntor, ata do të udhëtojnë në Bukuresht për t'u përballur me



Rumaninë, që aktualisht udhëheq grupin, ndërsa më 18 nëntor do të presin Lituani në "Fadil Vokrri".

Kosova U21 e përmyll me humbje ciklin kualifikues të 'Euro 2025'

Kosova U21 e ka përfunduar me humbje ciklin kualifikues për Kampionatin Evropian 2025, pasi në ndeshjen e fundit të grupit humbi me rezultat 3:1 në udhëtim ndaj Estonisë. Pas një humbjeje 4:0 nga Polonia, të premtën, në "Fadil Vokrri", "Dardanët" e rinj nuk arritën të riktheheshin në rrugën e rezultateve pozitive as në sfidën e së martës në Tallin. Pjesa e parë u mbyll me dy gola në disfavor të Kosovës. Në minutën e 21-të, Tristan Teevali realizoi nga pika e bardhë,

ndërsa Patrik Kristal shënoi për 2:0 në minutën e 44-të. Kosova përjetoi edhe më shumë vështirësi pas ndëshkimit të Yll Ibrahimit me karton të kuq në minutën e 70-të, çka e la ekipin me një lojtar më pak. Megjithatë, të përzgjedhurit e Afrim Tovërlanit arritën të ngushtojnë rezultatin me një supergol nga gjuajtja e lirë e Milot Avdylyt në minutën e 77-të. Në momentet kur Kosova po bënte përpjekje që me 10 lojtarë të barazojë shifrat, Estonia shfrytëzoi një rast dhe vulosi fitoren me golin e tretë nga Taaniel Usta, për rezultat përfundimtar 3:1. Kosova e mbylli Grupin D në vendin e katërt me 12 pikë. Gjermania kryeson grupin me 26 pikë, e ndjekur nga Polonia me 22 pikë, ndërsa Bullgaria përfundoi e treta me 13 pikë. Estonia u rendit e pesta me 7 pikë, ndërsa Izraeli i fundit me 4 pikë.

Kampionët e Kosovës presin në shtëpi MHP Riesen Ludwigsburg

MITROVICË, 15 TETOR - Trepça, kampionia e Kosovës në basketboll, do t'i ketë tri ndeshje radhazi në shtëpi në grupet e FIBA Europe Cup. Takimi i parë i mitrovicasve në Grupin H ishte ndaj JDA Bourgogne Dijon të Francës, ku pësuan 118:73. Tashmë "Xehetarët" do të kenë tri ndeshje në shtëpi: MHP Riesen Ludwigsburg më 16 tetor, Caledonia Gladiators 23 tetor dhe JDA Bourgogne Dijon më 30 tetor. MHP Riesen Ludwigsburg në ndeshjen e parë fitoi ndaj Caledonia Gladiators me rezultat 86:62. Më 5 nëntor do të ndeshen me MHP Riesen Ludwigsburg në Gjermani dhe takimi i fundit është kundër Caledonia Gladiators më 13 nëntor. Ky është edicioni i dytë radhazi që kampionët e Kosovës do të marrin pjesë në grupet e FIBA Europe Cup. Ndeshja e së mërkurës zhvillohet nga ora 19:00 në "Minatori".



SHKURT

Dy klube italiane në garë për Zhegrovën

Reprezentuesi i Kosovës, Edon Zhegrova, është kthyer në një nga emrat më të kërkuar në merkato. Talenti shqiptar ka tërhequr vëmendjen e skuadrave italiane, të cilat kanë gati ofensivën për ta blerë në fundin e sezonit. Zhegrova po monitorohet nga Roma dhe Atalanta që e konsiderojnë si përforcim të rëndësishëm për edicionin e ardhshëm. Lille ka refuzuar oferta të shumta nga klubet e interesuara dhe synon të bëjë rezistencë edhe në merkaton e janarit. Kontrata e lojtarit skadon më 30 qershor 2026 dhe mund të largohet për një shifër rreth 30 milionë euro. Zhegrova është lakuar shpesh për t'u larguar nga kampionati francez. Në 12 ndeshjet në total të luajtura deri më tani, 25-vjeçari ka shënuar 7 gola dhe dhuruar një asistime në të gjithë kompeticionet.

Xhaka për penalltinë ndaj Serbisë: Embolo mori përgjegjësinë

Granit Xhaka hezitoi të gjuante penalltinë ndaj Serbisë, në ndeshjen e humbur 2-0 nga Zvicra në Ligën e Kombeve. Kapiteni i "Helvetëve", Xhaka, tregoi arsyen për mediet, se përse lejoi që Embolo ta ekzekutonte 11-metërshin. "Bril ndihej mirë. Ne jemi një ekip dhe për mua ka shumë rëndësi nëse dikush ndihet mirë dhe kërkon të marrë përgjegjësi. Më pëlqejnë shumë lojtarët, të cilët në të tilla çaste hedhin një hap para dhe marrin përgjegjësi", ka thënë Xhaka. Kujtojmë që Embolo dështoi të shënonte nga penalltia.

Shqipëria pa Dakun ndaj Çekisë

Shqipëria nuk do të ketë në dispozicion Mirlind Dakun për ndeshjen ndaj Çekisë në Ligën e Kombeve, takim ky që do të luhet më 16 nëntor. Sulmuesi kuqezi u ndëshkua me karton të verdhë ndaj Gjeorgjisë, çka ka bërë që ai ta plotësojë numrin e tyre. Daku u impenjua 65 minuta në Çeki, ndërsa 25 minuta luajti në Gjeorgji. Futbollisti i lindur në Gjilan deri më tani numëron 8 ndeshje me përfaqësuesen, ku ka realizuar një gol.

Përzgjedhësi Shabani publikon listën e hendbollistëve

Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Agron Shabani, ka shpallur të martën listën e lojtareve në të cilat llogaritet për ndeshjet me Belgjikën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Kombëtarja e Kosovës është në grupin e dytë të fazës së parë kualifikuese për Botërorin 2025. Ndeshjet e këtij grupi zhvillohen në Hasselt të Belgjikës. Më 25 tetor është ndeshja Belgjikë - Kosovë, ndërsa më 26 tetor është takimi Kosovë - Bosnjë-Hercegovinë. Më 27 tetor takohen Bosnjë-Hercegovina e Belgjika. Lista e hendbollistëve: Sara Gjergjaj, Luljeta Esati, Yllka Shatri, Fitore Aliu-Berisha, Albina Rugova-Tahirukaj, Venera Kafegjollli, Leonora Demaj, Mijeta Bytyqi, Marigona Hajdari, Arlinda Dinarica, Aurora Kryeziu, Suzana Ujkiq, Dafina Mustafa, Elisa Mirdita, Angelina Krasniqi.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 16.10.2024, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Faturist-e - 1 pozitë

Vendi punës : Klinë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas ligjit të punës.

Koeficienti i pagës 1.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Punon me kompjuter në përpunimin dhe hartimin e faturave te konsumatorëve të sektorit industrial, institucioneve, dyqaneve dhe amvisërive;
2. Kryen evidencën e konsumatorëve të ri në datotekën e konsumatorëve;
3. Kryen përmirësimet e nevojshme që ndodhin gjatë muajit;
4. Kryen stornimin e faturave jo të rregullta që janë konstatuar nga komisioni;
5. arkivon shënimet sipas rregullave të përcaktuara të punës së softuerit;
6. Kryen përpilimin e listave të ngarkimit dhe shkarkimit;
7. Shtypë vërejtje për konsumatorët të cilët nuk i kryejn obligimet me afat.
8. Përgjigjet për aplikimin e drejt të programit, për përgatitjen e saktë dhe me kohë të faturave, punën e rregullte të kompjuterit, printerit etj.;
9. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuar nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
10. Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të Shefit te sherbimit te fakturimit dhe inkasimit .
11. Për mos respektimin e pikave te lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzkativ.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e Mesme ,përparsi Diplomë universitare
- 1 vite përvojë pune e dëshmuar ;
- Njohja e punës me kompjuter
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : Faturist-e - 1 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës 1.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Punon me kompjuter në përpunimin dhe hartimin e faturave te konsumatorëve të sektorit industrial, institucioneve, dyqaneve dhe amvisërive;
2. Kryen evidencën e konsumatorëve të ri në datotekën e konsumatorëve;
3. Kryen përmirësimet e nevojshme që ndodhin gjatë muajit;
4. Kryen stornimin e faturave jo të rregullta që janë konstatuar nga komisioni;
5. arkivon shënimet sipas rregullave të përcaktuara të punës së softuerit;
6. Kryen përpilimin e listave të ngarkimit dhe shkarkimit;
7. Shtypë vërejtje për konsumatorët të cilët nuk i kryejn obligimet me afat.
8. Përgjigjet për aplikimin e drejt të programit, për përgatitjen e saktë dhe me kohë të faturave, punën e rregullte të kompjuterit, printerit etj.;
9. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuar nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
10. Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të Shefit te sherbimit te fakturimit dhe inkasimit .
11. Për mos respektimin e pikave te lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzkativ.


a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e Mesme ,përparsi Diplomë universitare
- 1 vite përvojë pune e dëshmuar ;
- Njohja e punës me kompjuter
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 16.10.2024 deri me 31.10.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Zvogëlim kapitali nga "KFF EP HAJVALIA"

"KFF EP HAJVALIA" SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 811579509, bënë njoftim në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 150,000.00 €uro në vlerën 5,000.00 €uro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Majlind Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10 të shkollës së mesëm Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Danjell Gjini shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizrenit .

- Saide Likaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.

- Nashide Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Majlind Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10 të shkollës së mesëm Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

